


DUKE RIMENDUAR GRATË MUSLIMANE DHE MBULESËN

Sfida ndaj Stereotipeve Historike & Moderne



Seria e librave të shkurtërhit IIT

DUKE RIMENDUAR GRATË
MUSLIMANE DHE MBULESËN

Sfida ndaj Stereotipeve
Historike & Moderne

Katherine Bullock

Duke rimenduar Gratë Muslimane & Mbulesën: Sfida ndaj Stereotipeve
Historike dhe Moderne (botim i shkurtuar)

Titulli original

Rethinking Muslim Women and The Veil: Challenging Historical and Modern Stereotypes
(Abridged edition), The International Institute of Islamic Thought, 2010

Copyright © 2010 The International Institute of Islamic Thought

Botimi i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2018 Instituti Shqiptar i Mendimit dhe
i Qytetërimit Islam (AIITC)

ISBN 978-9928-126-19-1

Ky libër është e drejtë e autorit. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe në dispozitat
e marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, asnjë riprodhim i asnjë pjese nuk
mund të bëhet pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë libër janë ato të autorit dhe jo
medoemos ato të botuesve.


Përkthimi: Festime Mehdiu

Botues: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, www.aiitc.net

Redaktor: Nexhatin Ibrahimimi | **Redaktor teknik:** Suhejb Xhemaili

Shtypi: Mileniumi i Ri | Tiranë, 2018

Katherine Bullock



DUKE RIMENDUAR GRATË MUSLIMANE DHE MBULESËN

Sfida ndaj Stereotipeve
Historike & Moderne

Përkthimi:
Festime Mehdiu



Tiranë, 2018



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



PËRMBAJTJA

SERIA E LIBRAVE TË SHKURTËR HIT.....	7
HYRJE	9
HYRJE	11
KAPITULLI I PARË	
HIXHABI NË EPOKËN KOLONIALE.....	13
METAFIZIKA E MODERNIZMIT	15
VËSHTRIMI NGULTAS DHE MBULESA	16
PËRFUNDIM	17
KAPITULLI I DYTË	
PERCEPTIMET DHE PËRVOJAT E VESHJES SË HIXHABIT NË TORONTO	19
PERCEPTIMET E <i>HIXHABIT</i>	21
1. PËRSE HIXHABI?	21
2. INTERPRETIMI TRADICIONAL	
(D.M.TH. ME NJËANSHMËRI MASHKULLORE)?	22
KAPITULLI I TRETË	
KUPTIMET E SHUMËFISHTA TË <i>HIXHABIT</i>	25
ARSYET PËR MBULIM	26
KUPTIMI I <i>HIXHABIT</i> : PIKËPAMJA E MEDIAVE PERËNDIMORE	28

KAPITULLI I KATËRT

MERNISSI DHE DISKURSI MBI MBULESËN	31
MERNISSI DHE METODOLOGJIA	31
GRATË DHE SEKSUALITETI NË KURAN DHE SUNET	34
PËRFUNDIM	35

KAPITULLI I PESTË

Një TEORI ALTERNATIVE E MBULESËS	37
A. HIXHABI DHE ÇLIRIMI DHE	
B. HIXHABI DHE SHIKIMI MASHKULLOR	38
C. HIXHABI DHE FEMINITETI.....	40
Ç. HIXHABI, SEKSUALITETI DHE ESENCIALIZMI	41
D. HIXHABI DHE ZGJIDHJA.....	43
DH. HIXHABI DHE TË QENIT FETAR	44
E. PËRFUNDIM	45

PËRFUNDIM	47
-----------------	----

AUTORJA.....	51
--------------	----



SERIA E LIBRAVE TË SHKURTËR HIT

Seria e Librave të Shkurtër HIT është një koleksion i vlefshëm i botimeve kryesore të Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam, të shkruara në formë të kondensuar, për t'u dhënë lexuesve thelbin e përmbajtjes së origjinalit. Të riprodhuara në një format të shkurtër, të lehtë për t'u lexuar e që kursen kohë, këto përmbledhje ofrojnë një panoramë të ngushtë e të shkruar me kujdes të botimit më të madh, me shpresën që t'i stimulojnë lexuesit për të zbuluar më tej origjinalin.

Traktati i Dr. Katherine Bullock "Duke Rimenduar Gratë Muslimane dhe Mbulesën" u botua së pari nga HIT në vitin 2002 dhe më pas u ribotua më 2007-ën. Ky libër është një kritikë e fortë dhe inteligjente e nocionit popullor perëndimor të mbulesës si një simbol i shtypjes së grave muslimane. Duke trajtuar shumë nga shqetësimet kyçe social-politike që kjo çështje globale ka ngritur, autorja shqyrton fiksimin historik të Perëndimit me mbulesën (duke përfshirë aspektet e kolonializmit dhe fetishizmit me haremin), vlerëson diskursin feminist dhe ofron një teori alternative të mbulesës. Një veçori e rëndësishme e këtij punimi është zëri që autorja u ka dhënë pikëpamjeve, mendimeve dhe përvojave të një grupi grash muslimane të intervistuar në Kanada për temën e *hixhabit* (shamisë).

Autorja e përqafoi Islamin gjatë kandidaturës së saj për doktoratë. Është interesant fakti se përvoja e reagimit të njerëzve ndaj konvertimit të saj, ishte ajo që e çoi atë për të ndryshuar temën origjinale të tezës së doktoratës së saj dhe për të zgjedhur në vend të asaj teze studimin e mbulesës. Nëpërmjet studimit të kujdesshëm dhe të përpiktë në një zonë të mbushur me konceptime të gabuara historike dhe kulturore, autorja ka kërkuar të sfidojë disa nga bazat subjektive dhe negative të cilat po dominojnë sot shumicën e diskutimeve në këtë çështje të rëndësishme.

Puna e Dr. Bullock përbën një sfond të rëndësishëm për çdo studim apo debat të kësaj çështjeje politike të madhe dhe në rritje, që mbulesa është bërë në Perëndim.

Botim i shkurtuar i librit origjinal të Katherine Bullock

DUKE RIMENDUAR GRATË MUSLIMANE DHE MBULESËN

Sfida ndaj stereotipeve historike dhe moderne

Katherine Bullock ISBN hbk: 9781565644335

ISBN pbk: 9781565644328

2007



HYRJE

Në vitin 1991 pashë një raport lajmesh në televizion, që tregon-te se gratë turke po ktheheshin te mbulesa. U ndjeva e tronditur dhe e pikëlluar për ato. Të gjorat, mendova, po iu shpëlahet truri nga kultura e tyre. Ashtu si shumë perëndimorë, besoja se Islami shtypte gratë dhe se mbulesa ishte një simbol i shtypjes së tyre. Imagjinoni habinë time atëherë, katër vjet më vonë, duke parë reflektimin tim në një dritare të dyqaneve, të veshur tamam si ato gra të shtypura. Unë kisha nisur një udhëtim shpirtëror gjatë magjistraturës që kulmoi katër vjet më vonë në konvertimin tim në Islam. Udhëtimi përfshiu lëvizjen nga urrejtja ndaj Islamit, në respekt, në interesim, në pranim. Natyrisht, duke qenë një grua, çështja e mbulesës ishte qendrore.

Përkundër tërheqjes sime ndaj themeleve teologjike të Islamit, unë u shqetësova thellësisht nga ajo që besoja se ishte praktika shtypëse ndaj grave. Ndjeva se mbulesa ishte një traditë kulturore që gratë muslimane me siguri do të punonin për ta eliminuar. Më treguan ajetet në Kuran, për të cilat shumë muslimanë besojnë se urdhërojnë të mbulohen burrat dhe gratë; mua më dukej e qartë se ajetet, me të vërtetë, kishin imponuar mbulimin. Kam humbur në shtëpi, duke u ndjerë mjaft në depresion dhe keq për gratë muslimane. Nëse ajetet ishin të qarta, ato nuk

kishin asnjë mbështetje: mbulesa do të kërkohej për një grua besimtare muslimane.

Unë duhej t'i lija këto çështje mënjanë, në mënyrë që të vendosja nëse do të pranoja Islamin apo jo. Ajo që llogaritej në analizën përfundimtare, ishte mesazhi themelor teologjik i fesë se ekziston një Zot i vetëm dhe se Muhamedi s.a.v.s.,¹ ishte Shërbëtori dhe i Dërguari i Tij i fundit. Pas disa vitesh studimi nuk kisha dyshim për këtë ... po të mos ishte vetëm për çështjen e grave dhe Islamit.

Kur më në fund mora vendimin për t'u konvertuar, një vit e gjysmë pasi kisha nisur doktoratën (korrik 1994), vendosa që, më pëlqente apo jo, duhet të mbulohesha. Ishte një urdhërim dhe unë do t'i bindesha. I paralajmërova disa njerëz në departamentin tim, se isha bërë muslimane dhe se herën tjetër që do të më shihnin, do të isha e mbuluar. Është e panevojshme të thuhet se njerëzit ishin mjaft të tronditur dhe, ndërsa fjala u përhap (dhe kur njerëzit më panë në veshjen time të re), u gjenda subjekt i një trajtimi armiqësor. Si mund të kisha përqaftuar një praktikë shtypëse, sidomos kur isha e njohur si një feministe e fortë dhe e përkushtuar?! Si mund ta përqafoja Islamin? A nuk e kisha dëgjuar atë që sapo kishte bërë Hamasi?! A nuk e kisha dëgjuar atë që një burrë musliman i kishte bërë një gruajë?! Nuk isha e përgatitur sa duhet për këtë armiqësi, as nuk isha e përgatitur për mënyrën e ndryshme që po trajtohesha nga sekretarët, burokratët, personeli mjekësor ose të huajt në përgjithësi në metro. U ndjeva njëlloj, por shpesh u trajtova me përbuzje. Nuk u trajtova ashtu si isha unë, një grua e bardhë e klasës së mesme. Ishte përvoja e parë personale e diskriminimit dhe e racizmit dhe më bëri të shoh pozitën time të mëparshme të privilegjuar në një mënyrë që kurrë më parë nuk e kuptoja siç duhej.

1 Shkurtesa "s.a.v.s. - *sal-I'Alil-llahu 'alejhi ve sel-lem, në përkthim domethënë 'Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Të.'* Thuhet çdoherë kur përmendet emri i profetit Muhamed.



HYRJE

Mikeshat e mia të reja muslimane (duke përfshirë shumë të konvertuara) më ngushëllonin, ndërsa negocioja rrugën përmes fesë sime të re dhe reagimeve që po përjetoja nga komuniteti më i gjerë. Si e menaxhuan mikeshat e mia këtë situatë, pyeta veten? A e kanë përjetuar ato që kanë veshur *hixhabin* në Toronto në të njëjtën mënyrë si unë, apo thjesht po tregohesha tepër e ndjeshme?! Vërtet më shikonin me ngulm njerëzit në metro, apo po shihnin diçka tjetër?! Pse u trajtova me keqardhje dhe / ose me përbuzje? Gjatë kësaj kohe të vështirë po kërkoja një temë për disertacionin e doktoratës dhe, megjithëse u përpoqa ta shmannga atë për pak kohë, u bë e qartë se reagimi ndaj shamisë islame ishte një temë e denjë për t'u eksploruar.

Pse mbulesa shihej si simbol i shtypjes në Perëndim? Pse Perëndimi duket dashakeqës ndaj Islamit? Si mund të ndihehim unë dhe miqtë e mi të përkushtuar ndaj diçkaje që e provuam se ishte çliruese, por ende të ishim në aq shumë konflikte me shoqërinë jomuslimane rreth nesh?! Pse njerëzit nuk e dinin versionin tonë të Islamit dhe të shamisë?

Ky libër është rezultat i udhëtimit për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Qëllimi kryesor i librit "Duke rimenduar gratë muslimane dhe mbulesën" është të sfidojë stereotipin popullor

perëndimor, se mbulesa është shtypëse. Argumenti im kryesor është se perceptimi popullor perëndimor që mbulesa është simbol i shtypjes së grave muslimane, është një imazh i ndërtuar i cili nuk përfaqëson përvojën e atyre që e veshin atë. Ai ndërtim gjithmonë ka shërbyer për qëllimet politike perëndimore dhe vazhdon ta bëjë këtë edhe në fund të shekullit të njëzetë. Përveç kësaj, argumentoj se gjykimi që mbulesa është shtypëse, bazohet në kuptimet liberale të *barazisë* dhe *lirisë*. Këto kuptime liberale pengojnë mënyra të tjera të të menduarit për *barazinë* dhe *lirinë*, që ofrojnë një qasje më pozitive për të menduar veshjen e mbulesës.



KAPITULLI I PARË

HIXHABI NË EPOKËN KOLONIALE

Kur u bë mbulesa simbol i shtypjes në Perëndim? Megjithëse nuk kam qenë në gjendje të përcaktoj origjinën e idesë, është e qartë se në shekullin e tetëmbëdhjetë, mbulesa tashmë ishte marrë nga evropianët për të qenë një zakon i shtypjes midis muslimanëve. Zonja britanike Mary Wortley Montagu, e cila udhëtoi në Turqi me bashkëshortin e saj diplomat Edward Wortley Montagu në 1717-1718, kundërshtoi idenë se mbulesa ishte shtypëse. Duke provuar mbulesën kur ishte në Turqi, ajo argumentoi se mbulesa u jepte grave liri, sepse u lejonte atyre të dilnin jashtë të panjohura.² Sidoqoftë, nocioni i mbulesës si shtypëse mori një fokus të ri dhe të rëndësishëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, sepse kjo ishte epoka e kolonizimit evropian të Lindjes së Mesme. Siç tregon Ahmed në librin e saj, kolonialistët e shfrytëzuan atë fokus të ri në gjendjen e grave pjesërisht për të justifikuar pushtimin dhe kolonizimin e Lindjes së Mesme.

2 *The Complete Letters of Lady Mary Wortley Montagu*, të cituara në Leila Ahmed, *Women and Gender in Islam: Historical Roots of a Modern Debate* (New Haven: Yale University Press, 1992), f. 150.

Gjatë epokës koloniale, evropianët, burra dhe gra, qofshin ata kolonialistë, udhëtarë, artistë, misionarë, studiues, politikanë apo feministë, ishin në një mendje se gratë muslimane shtypeshin nga kultura e tyre. Mbulesa u përfshi si pjesë e një liste të zakonshme të padrejtësive me të cilat ballafaqoheshin gratë muslimane: poligamia, izolimi, divorci i lehtë mashkullor. Në të vërtetë, mbulesa u bë simboli për statusin e degraduar të grave dhe metafora e degjenerimit të Orientit, që ushqyen pikëpamjen orientaliste të kulturave evropiane ndaj Lindjes së Mesme.³

Jo vetëm Perëndimi ishte i bindur për natyrën shtypëse të mbulesës; edhe elitat vendore e përvetësuan qasjen orientaliste ndaj vetvetes. Ata u bindën se ishin të prapambetur, se gratë e tyre ishin në gjendje të keqe dhe se duhet të ndiqnin recetat perëndimore për t'u përmirësuar. Zbulimi (i grave) u bë urgjencë qendrore për elitat që përpiqen të 'arrijnë' Perëndimin. Kështu, mbulesa u bë simbol i fuqishëm i progresit ose regresit të një kombi.⁴

Duke qenë se klasat e larta ishin 'modernizuese', diskursi kundër mbulesës ishte, gjithashtu, një sulm ndaj atyre klasave që mbetën të lidhura me mbulesën dhe kuptimet e saj më të vjetra simbolike (simbol i devotshmërisë / i pasurisë / i statusit).⁵ Diskursi kundër mbulesës hapi një hendek midis njerëzve të një kombi. Nga njëra anë ishin elitat e përqendruara në Perëndim dhe ata që po adoptonin kulturën e kolonizatorit e po përfitonin ekonomisht e shoqërisht nga kolonializmi. Në anën tjetër, ishin klasat më të ulëta, mësuesit tradicionalë muslimanë e të tjerë të cilët, ashtu si vuajtën nga kolonializmi, nuk po asimiloheshin në mënyrat perëndimore.⁶

3 Orientalizmi u bë një fushë e dijes për të kuptuar Lindjen e Mesme dhe Islamit, ose paradigmë që pretendonte objektivitetin (paanshmërinë), por që në fakt ishte bazuar në supozimin udhëzues të inferioritetit të pandarë oriental. Edward Said, *Orientalism* (1979, 2nd Ed., New York: Vintage Books, 1994), f.209.

4 Ahmed, *Women and Gender in Islam*, f.128.

5 Ibid., fq. 12930.

6 Ibid., f. 145.

Kështu, nocioni që mbulesa është shtypëse është një ide e lindur nga dominimi, ose, të paktën, nga vullneti për të dominuar. Çdo argument që çon para nocionin se mbulesa është simbol i shtypjes së grave muslimane tërheq, me ose pa dashje, drejt diskursit orientalist dhe kolonial rreth mbulesës. Kjo është ndoshta arsyeja pse debatet mbi mbulesën mund të marrin përmasa të tilla të zemëruara. Mbulesa, siç vëren Ahmed, që nga periudha koloriale “ka bartur” “ngarkesën” e orientalizimit të kuptimeve.⁷ Përplasjet sot në botën muslimane mbi *hixhabin* pasqyrojnë këto ndarje klasash / kulturash.

METAFIZIKA E MODERNIZMIT

Nëse mbulesa ishte parë në Perëndim si shtypëse, të paktën që prej viteve 1700, atëherë çfarë solli një vëmendje të re për mbulesën në epokën koloriale të shekullit XIX? Në këtë kapitull do të argumentoj se është natyra e mbulesës si frenuese e vështrimeve ajo që më së shumti sjell sulmet kundër saj. Megjithëse dinamika në lojë filloi gjatë kolonializmit modern, vështrimet vazhdojnë deri në ditët e sotme dhe shpjegojnë sulmet bashkëkohore mbi mbulesën. Analiza ime shtjellon argumentin e Timothy Mitchell në librin e tij “Kolonizimi i Egjiptit” për takimin midis “metafizikës së modernizmit” evropian, në të cilën individi vjen të përjetojë veten si jashtë botës dhe kapjen e botës materiale sikur të ishte një foto (fjalasiekspozitë), me një metafizikë jo-evropiane, e cila nuk është krijuar për të lejuar që bota materiale të përfaqësohet si një pamje.⁸

7 Ibid., f. 129.

8 Timothy Mitchell, *Colonising Egypt* (Berkeley: Uni. of California Press, 1988), fq. 1213, passim.

VËSHTRIMI NGULTAS DHE MBULESA

Ajo që më duhet të theksoj për përvojën moderne të ekspozimit në botë, është përparësi që i jepet kërkimit: “Vetëm tani jemi një popull objektiv,” shkroi *The Times* në verën e vitit 1851, me rastin e Ekspozitës së Madhe. “Ne duam të vendosim gjithçka që mund t’i shtrijmë duart në kutitë e qelqit dhe të vështrojmë me ngulm mbushjen tonë.”⁹

Mitchell thekson se kjo është përvoja moderne e ‘objektivitetit’: ndjenja se dikush është në gjendje të shohë poshtë dhe të vëzhgojë botën nga një vend neutral. Atëherë, çfarë ndodh kur dikush has një botë të krijuar për të mohuar vështrimin? Vështrimi kërkon një kënd për të parë, por jo për t’u parë dhe që vendasit të paraqiten si një spektakël. Nuk është e vështirë të shihet menjëherë se sa i frustruar do të ishte një vizitor evropian në epokën koloniale pas arritjes në Lindjen e Mesme, ku gratë mbulonin fytyrat me mbulesa. Gratë nuk e paraqisnin veten si një ekspozitë. As shtëpitë në të cilat ata jetonin (*lattices* ishin mbi dritare që shikonin në rrugë), as veçimi mashkull / femër nuk e lejonin atë.

Gratë e mbuluara shkelën të gjitha kërkesat e botës si ekspozitë, sepse nuk mund të shiheshin. Ato nuk mund të shiheshin, por po shihnin dhe nuk ishin një foto që mund të lexohej. Ato ishin qenie misterioze që refuzuan të ofrojnë veten tek vizitorët. Për mua, ky është një aspekt kyç i fushatës evropiane kundër mbulesës. Evropianët arritën në Lindjen e Mesme me bindjen e sigurt të të qenit në kulmin e civilizimit, por kjo bindje u destabilizua pas mbërritjes në Lindjen e Mesme. Si mund të ishte një njeri superior, apo të krijonte autoritet mbi krijesa të cilat nuk mund të njiheshin (sepse nuk mund të shiheshin, të kapeshin si foto)? Ajo që nuk mund të shihej, të kapej si një spektakël, nuk mund të kontrollohej.

9 Ibid., fq. 1920.

Për më tepër, evropianët ndiheshin të shqetësuar për gratë e mbuluara: ata e dinin se po shiheshin nga gratë që vetë ishin të padukshme. Kjo u dha grave disa fuqi mbi evropianët. Ky ishte një ndryshim i marrëdhënieve të pritura midis superioritetit dhe inferioritetit për të parë pa u parë. Dhe këtu thelbi i argumentit tim, evropianët u hakmorën. Ata sulmuan mbulesën, u përpoqën ta shqyejnë atë; ata provuan çdo gjë që mundën për të parë gratë. Ata i ekspozonin gratë në piktura, fotografi etj., duke i portretizuar ato lakuriq a të zhveshura. Dhe kështu filloi fushata për të zbuluar gratë muslimane.

PËRFUNDIM

“Metafizika e modernizmit”, ku kuptimi merret si një dallim midis një gjëje materiale dhe strukturës jomateriale që ajo përfaqëson, me theksin e saj në vështrim, i udhëhoqi vizitorët evropianë në Lindjen e Mesme për të sulmuar mbulesën. Mbulesa ishte për Evropën një pengesë që mbaronte deri në përfundimin e projektit të promovuar nga vizioni orientalist ndaj Orientit: domethënë inferioritetin e pandarë të Orientit dhe nevojën që Perëndimi ta civilizonte atë. Diskursi kolonial gjithashtu prezantoi ide rreth inferioritetit oriental dhe fokusit në statusin e grave si pikë referimi për progresin në diskursin e kolonizuar. Elitat vendore rrokën kuptimin evropian për praktika të caktuara, si mbulesa dhe haremi, në përpjekjet e tyre për të “modernizuar” shoqërinë. Kuptimeve më të vjetra paramoderne të mbulesës si simbol i devotshmërisë, pasurisë apo statusit, iu shtuan kuptimet që mbulesa simbolizonte shtypjen dhe prapambetjen. Domethënia e re nuk i zhvendosi kuptimet e vjetra, por vetëm krijoi një shtresë të re që i ishte bashkëngjitur pozicionit të klasës së dikujt. Kështu u rrit ndarja mes pakicës, elitës pro-perëndimore

dhe shumicës joperëndimore dhe joelitare. Siç pohon Ahmed, diskursi mbi *hixhabin* është “i njollosur” me “historinë e dominimit kolonial, rezistencës dhe luftës së klasave rreth kësaj”.¹⁰ Këto dinamika janë duke animuar luftërat në botën muslimane sot.

10 Ahmed, *Women and Gender in Islam*, f. 104.



KAPITULLI I DYTË

PERCEPTIMET DHE PËRVOJAT E VESHJES SË HIXHABIT NË TORONTO

Menjëherë pas fillimit të veshjes së *hixhabit*, dy vajza shkollore në Montreal, Quebec, Kanada, u dërguan në shtëpi nga shkolla për refuzimin e heqjes së shamive të tyre në klasë.¹¹ Incidentet nxitën një debat në të gjithë Kanadanë për kuptimin e *hixhabit* dhe vendin e tij në shoqërinë kanadeze. Kontradikta në Kanada rreth kuptimit të shamisë u bazua në faktin që ajo ishte një praktikë ‘e huaj’, të cilën kanadezët duhej të vendosnin nëse do ta pranonin ose jo si ‘autentike’. Një raport hetimor i Komisionit Kanadez të Transmetimit (KKT) shtroi pyetjen: “A mund të kalojë *hixhabi* provën e lakmisë për të qenë kanadeze?”¹² Që vajzat që u dëbuan ishin kanadeze (të lindura dhe të edukuara) dukej e parëndësishme. Komenti i Jeffery Simpson në *The Globe and Mail*, i cili argumentoi se gratë muslimane duhet të kenë të

11 Çështja e Quebecut u pasua nga dëbimet franceze të vajzave me *hixhab* në vitin 1989. Natyrisht, ka lidhje midis kulturës franceze dhe Quebecut.

12 Komisioni Kanadez i Transmetimit, Prime Time News, korrik, 1995.

drejtën të mbajnë *hixhabin* nëse dëshirojnë,¹³ nxiti një përgjigje të zemëruar nga dy gra, duke përmendur se *hixhabi* ishte “në mënyrë të qartë një shenjë e shtypjes së grave muslimane”.¹⁴

Ajo që u errësua në këto debate popullore ishin, zërat e vet grave muslimane të mbuluara. Ky kapitull përpiket ta mbushë këtë boshllëk, duke paraqitur zërat e disa grave muslimane kanadeze që mbulohen. Unë nuk përgjithësoj nga pikëpamjet e tyre ‘të gjithë muslimanët’. Qëllimi im ishte thjesht të fitoj një kuptim të plotë të asaj që disa gra muslimane mendonin për *hixhabin*. Midis majit dhe korrikut 1996 kam intervistuar pesëmbëdhjetë gra sunite dhe një ismailite (shi’ite), të cilat jetonin në zonën më të madhe të Torontos, Ontario, Kanada. Nga gjashtëmbëdhjetë syresh, gjashtë ishin të konvertuara në Islam. Dhjetë kishin veshur *hixhabin* gjatë gjithë kohës (prej të cilave pesë ishin të konvertuara) dhe pesë kishin veshur *hixhabin* nganjëherë. Vetëm dy prej këtyre grave nuk synonin të mbanin *hixhabin* gjatë gjithë kohës në një moment, në të ardhmen. Nga pesëmbëdhjetë muslimanet sunite, vetëm njëra nuk i kryente pesë lutjet e përditshme, kështu që pjesa tjetër (përfshirë Nohan, ismailite, që ishte aktive në bashkësinë e saj fetare) ishin të atilla që njerëzit e tjerë i konsideronin “fetare”.¹⁵ Kjo i bënte ato pjesë të minorancës në mesin e muslimanëve në Amerikën e Veriut, të cilat ishin pjesëmarrëse aktive në xhami (rreth 15 për qind), sipas dijetarëve të Islamit në Amerikën e Veriut.¹⁶ Për të ruajtur anonimitetin e të intervistuarave të mia, u kam dhënë pseudonime.

13 Jeffery Simpson, “The Current Objections to Muslim Clothing are Simply Wronghe aded,” *Globe and Mail* (Toronto, Canada), dhjetor 28, 1994, f. A16.

14 Mona LeBlanc, Letters to the Editor, *Globe and Mail*, e mërkurë, janar 4, 1995.

15 Unë them “njerëz të tjerë”, sepse shumica e të intervistuarave, megjithëse i theksuan pesë shtyllat e Islamit, nuk e konsideronin veten “fetare”. Ato mendonin se do të duhej të bënin më shumë lutje, ose të lexonin më shumë Kuran, për të qenë me të vërtetë fetare.

16 Yvonne Yazbeck Haddad, “Arab Muslims and Islamic Institutions in America: Adaptation and Reform,” in *Arabs in the New World: Studies on Arab-American Communities*, eds. Sameer Y. Abraham and Nabeel Abraham (Detroit: Wayne State University Centre for Urban Studies, 1983), f. 75.

PERCEPTIMET E *HIXHABIT*

1. PËRSE HIXHABI?

Grave muslimane me *hixhab* nganjëherë u thuhet nga kanadezët: “Kjo është Kanada. Jeni të lira këtu. Nuk keni nevojë ta vishni atë gjë në kokën tuaj”. Të qenit objekt i komenteve të tilla mund të jetë zbavitës ose tronditës, në varësi të stilit në të cilin jepet ky informacion.

Nur, një e diplomuar nga Azia Jugore, pati një takim traumatic në kafenetë e bibliotekës një ditë, kur asaj iu afrua një grua më e vjetër e cila e pyeti në mënyrë armiqësore, sepse Nur po e “çonte prapambetjen në Kanada”. Gruaja theksoi se ato ki shin “punuar shumë në Kanada për të drejtat e grave” dhe veshja e *hixhabit* do të “shkatërronte gjithë këtë”. Sapo Nur theksoi se nuk po bënte një deklaratë për të tërhequr vëmendjen, apo për ta bërë veten “një nga objektivat e lehtë për urrejtje”, por që ishte “më shumë një gjë fetare”, gruaja “u duk se ... u qetësua”, edhe pse “ende nuk ishte e bindur”, ndoshta duke menduar se Nur nuk duhet të veshë *hixhabin*, pavarësisht nga arsyeja.

Nur dha arsye fetare, kur përpiqej t’i shpjegonte gruas jomuslimane kanadeze, përse ajo mbante *hixhabin* në Kanada. Të gjitha të intervistuarat e mia mendonin se veshja e *hixhabit* ishte pjesë e fesë. Madje edhe Fatima, e cila mbulohej rrallë, ndryshe nga gratë e tjera që nuk mbuloheshin gjatë gjithë kohës, apo që nuk dëshironin ta bënin atë një ditë, mendonte kështu. Kur i pyeta se çfarë i bënte të mendonin se mbulesa ishte pjesë e fesë, të gjitha u përgjigjën se “është në Kuran”, “Zoti e urdhëron atë në Kuran” dhe kështu me radhë. Bassima, një angleze e konvertuar në Islam iu referua, gjithashtu, “haditheve që thonë se, kur një grua arrin pubertetin, asaj nuk duhet t’i shihet asgjë, përveç fytyrës dhe duarve”.

2. INTERPRETIMI TRADICIONAL (D.M.TH. ME NJËANSHMËRI MASHKULLORE)

Studiueset gra që nuk janë të mbuluara vetë, kanë shkruar shumicën e studimeve të tyre mbi lëvizjen e rimbulesës. Shumë prej tyre hedhin dyshime mbi pohimet e të intervistuarave të tyre, se Kurani e obligon mbulimin. Nga këndvështrimi i këtyre studiueseve, Kurani thjesht kërkon veshje modeste, jo llojin e mbulimit që përshkruajnë islamistët. Përgatitja e studimeve të tyre në këtë mënyrë i dëmton gratë që ato kanë intervistuar për artikujt shkencorë, sepse nënkupton se ato janë më në gjendje të interpretojnë Kuranin sesa të intervistuarat e tyre. Një mënyrë më e mirë për t'iu qasur ndryshimeve në interpretim është modeluar nga studimi i Karam për feminizmin egjiptian. Ndërsa vetë nuk pajtohet me interpretimin e grave islamike, se mbulimi është i urdhëruar në Kuran, ajo ndien një respekt të thellë për metodologjinë e tyre: "Ishte një situatë klasike e kapur: Unë si një grua muslimane e cila u rrit me bindje islamike, nuk mund të mohoja legjitimitetin e bazës së tyre islame (d.m.th. Kuranin), ndërkohë që nuk mund të pranoj interpretimet që përdorën me implikimet e tyre sociale."¹⁷ Karam vë në dukje se të dyja palët, si ato që mbulohen, ashtu edhe ato që nuk mbulohen, janë të bindura se tjetri është mashtruar nga ndërgjegjja e rreme.¹⁸

Nocioni se gratë që zgjedhin të mbulohen po vuajnë nga vetëdija e rreme, është shumë i fortë në Perëndim. Kur fillova të vishja *hixhabin* në universitet, një nga shokët e mi të klasës i tha shokut tim: "A nuk e di se ajo është e shtypur?" Sidoqoftë, asnjë grua nuk mund të zgjedhë të mbulohet këto ditë, veçanërisht duke u rritur në Perëndim, pa qenë e vetëdijshme për të gjitha debatet brenda dhe jashtë bashkësisë muslimane rreth kësaj

17 Azza M. Karam, *Women, Islamisms and the State: Contemporary Feminisms in Egypt* (London: Macmillan, 1998), f. 133.

18 *Ibid.*, f. 139.

praktike. Mbulimi ka një traditë të gjatë në botën muslimane. Debatet e tanishme mbi të janë relativisht të reja, të shkaktuara nga takimi kolonial me Perëndimin. Duke jetuar në Kanada, nuk është e lehtë të vendosësh për të veshur *hixhabin*, duke pasur parasysh vlerësimin negativ ndaj tij nga komuniteti më i gjerë dhe përvojat e ngacmimit dhe të diskriminimit që përgjithësisht vijnë me të. Gratë që kam intervistuar, nuk e kanë marrë vendimin për t'u mbuluar dhe për ta mbajtur mbulesën ditë pas dite, pa e menduar mirë pse do ta vishnin atë. Studiuesit e lëvizjes së rimbulimit zbuluan se kishte motive të ndryshme për gratë që të vendosnin *hixhabin*, duke nisur nga protestat politike, te arsyet ekonomike, te devotshmëria (shih kapitullin e tretë). Të intervistuarat e mia kanë konsideruar interpretime të ndryshme të Kuranit dhe kanë zgjedhur atë që u ka dhënë më shumë kuptim atyre. Të gjithë besonin se ajeti kuranor që iu kërkonte grave të mbulonin flokët, ishte i drejtpërdrejtë.

Perceptimi publik për Islamin e sheh atë si një fe të keqe, që nxit dhunën dhe shtypjen e grave. Megjithatë, për gratë në studimin tim, *hixhabi* nuk simbolizonte as shtypjen, as terrorizmin, por “pastërtinë”, “modestinë”, “identitetin islam të gruas” dhe “bindjen, nënshtrimin ndaj Zotit dhe dëshminë se je musliman”. Ato ndiheshin të qeta në *hixhabin* e tyre dhe u pëlqente veshja e tij. Ato besonin në mënyrë të vendosur se *hixhabi* është një përfitim për shoqërinë, sepse ai “pastron” ndërveprimin mashkull - femër; se ato ndiheshin të trajtuara si persona, jo “objekte seksuale”; dhe se ndjenjat negative të zilisë dhe të xhelozisë do të pakësoheshin në një shoqëri në të cilën gratë mbulohen. Nëse metodologjitë feministe dhe epistemologjitë e përvojës si bazë për njohuri do të thonë diçka, këto kuptime të *hixhabit* do të duhej të merreshin seriozisht dhe gratë nuk do të talleshin se mbajnë besime gjoja “të rreme”.



KAPITULLI I TRETË

KUPTIMET E SHUMËFISHTA TË *HIXHABIT*

Kompleksiteti sociologjik i mbulesës nuk është rrokur nga mençuria konvencionale në Perëndim që thotë se “mbulesa” (sikur ajo është vetëm një lloj) është një simbol i shtypjes së grave në Islam. Shqetësimi im në këtë libër është të sfidoj supozimin e përbashkët Perëndimor, që çdo grua e cila mban shami, e bën këtë me forcë ose me detyrim dhe se shamia përfaqëson shtypjen e saj në Islam. Ky kapitull përqendrohet në kuptimet e shumta të *hixhabit*, për të treguar se një vëzhgues nuk duhet të lexojë një kuptim të vetëm në të dhe për të theksuar padrejtësinë që u bëhet grave në Perëndim, të cilat vuajnë nga imponimi i kuptimit “mbulesa është shtypëse” (për shembull, vajzat që janë dëbuar nga shkolla në Francë dhe Quebec, dhe gratë muslimane që vuajnë nga diskriminimi ose ngacmimi në punë, sepse mbulohen). Praktikrat e grave muslimane në vende të tjera janë analizuar këtu për të treguar kuptimet e shumta të *hixhabit*, të cilat ndryshojnë sipas kontekstit dhe dallimeve individuale. Unë kam përmbledhur shtatë tema thelbësore nga studimet akademike rreth mbulimit, për të kapur motivet e ndryshme të grave

për mbulimin: protesta revolucionare, protesta politike, fetare, qasja e vazhdueshme në sferën publike, shprehja e identitetit personal, normat zakonore dhe shtetërore. Natyrisht, ka një ndërthurje midis temave që kam identifikuar dhe më shumë se njëra mund të aplikohet për të njëjtën grua. Në pjesën e mëposhtme do të paraqes temat e mbulimit të marra nga këto studime. Më pas do të shohim kuptimin që mediat bashkëkohore perëndimore zakonisht i përshkruajnë *hixhabit*. Kjo mjafton për të treguar se në Perëndim, imazhi i *hixhabit* që gjenerohet nga mediat, është tej mase negativ dhe pak i lidhur me këndvështrimin e grave.

ARSYET PËR MBULIM

- (1) *Protesta Revolucionare*: Gjatë luftës algeriane për pavarësi, në vitet 1950 dhe në Iran në vitet 1970, gratë që nuk ishin mbuluar më parë, veshën mbulesën / *chador* (*çarçafin*) për të ndihmuar përmbysjen e qeverive shtypëse.¹⁹ Shamia e kokës tregoi se ishte kundër kolonializmit ose kundër regjimit simpatik perëndimor të elitës dhe gjithçka për të cilën ajo qëndronte.
- (2) *Protesta politike*: Gratë vënë *hixhabin* si protestë politike kundër programeve të elitës perëndimore dhe neo imperia- lizmit perëndimor, për të sinjalizuar se nuk janë të kënaqura me situatën aktuale politike, ose me politikat e ndjekura nga shteti dhe / ose me pushtimin “komercial, teknologjik, politik dhe social” të vendeve të tyre nga Perëndimi.²⁰

19 Për Algerinë, shih Frantz Fanon, *A Dying Colonialism*. Përkth. Haakon Chevalier (New York: Grove Press, 1967). Botimi në frëngjisht, 1959, f. 6162, *passim*. Për Iranin, shih Azar Tabari, “Islam and the Struggle for Emancipation of Iranian Women,” in *In the Shadow of Islam: The Women’s Movement in Iran*, eds. Azar Tabari dhe Nahid Yeganeh (London: Zed Press, 1982), f. 13.

20 Sherifa Zuhur, *Revealing Reveiling: Islamist Gender Ideology in Contemporary Egypt* (New York: State University of New York Press, 1992), f. 108.

- (3) *Arsye fetare*: Pjesë përbërëse e protestës politike kundër perëndimizimit dhe shekullarizimit është një bindje për Islamin si një sistem alternativ, politik, shoqëror dhe ekonomik. Shumë gra kanë vendosur të mbulohen në bazë të thirrjeve të kësaj lëvizjeje ndërkombëtare për burrat dhe gratë, që të respektojnë ‘kodin e veshjes islame’.²¹
- (3.1) *Bëjeni shoqërinë më të mirë*: Së bashku me temat e refuzimit të perëndimizimit e të shekullarizimit dhe të adoptimit të Islamit si alternativë, është përhapur edhe ideja se gratë që mbajnë *hixhabin*, ndihen se po tregohen vepruese në përmirësimin e shoqërisë. Në këtë pikëpamje, *hixhabi* përfaqëson në mënyrë ideale një nivelim të klasave shoqërore.²² Williams zbuloi se gratë në Egjipt ndiheshin se e kishin veshur *hixhabin* si një mënyrë për të përmirësuar shoqërinë, për ta ndaluar atë që të mos rrezohej, për të ndaluar *inhilalin* (shthurjen).²³
- (4) *Qasje e vazhdueshme në sferën publike*: Jo të gjitha gratë që kanë filluar të mbulohen vitet e fundit, e kanë bërë këtë nga bindja fetare. Këto gra, disa prej të cilave kurrë nuk falen, kanë zbuluar se *hixhabi* lehtëson aksesin dhe lëvizjen në sferën publike: kërkimin e punësimit, fitimin e respektit dhe luftimin e ngacmimeve mashkullore.²⁴

21 John Williams, "A Return to the Veil in Egypt," *Middle East Review*, 11,3, (1979), f. 50.

22 Zuhur, *Revealing Reveiling*, f. 2. Zuhur e gjeti këtë ideal të kundërshtuar nga Yves St. Laurent, linja për shamitë në dispozicion për t'u blerë. Shihni, gjithashtu: Leila Hessi ni, "Wearing the *Hijab* in Contemporary Morocco: Choice and Identity," në *Reconstructing Gender in the Middle East: Tradition, Identity, and Power*, eds. Fatma Miige Go^ek and Shiva Balaghi (New York: Columbia University Press, 1994), f. 50.

23 Williams, "A Return to the Veil," f. 54.

24 Homa Hoodfar, "Return to the Veil: Personal Strategy and Public Participation in Egypt," në *Working Women: International Perspectives on Labour and Gender Relations*, eds. Nanneke Redclift and M. Thea Sinclair (London: Routledge, 1991), f. 110-111; Arlene Elowe Macleod, *Accommodating Protest: Working Women and the New Veiling in Cairo* (New York: Columbia University Press, 1991), f. 114, 121.

- (5) *Shprehja e identitetit personal*: Një arsye tjetër për mbajtjen e *hixhabit*, sidomos për gratë muslimane në Perëndim, është për të shpallur identitetin personal. Kështu shprehet Nadia, një grua anglo-aziatike e gjeneratës së dytë, e cila filloi të mbulohej kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç: "...veshja e mbulesës më bën të ndihem e veçantë; është një lloj karte identiteti dhe një shenjë se feja ime është e rëndësishme për mua".²⁵
- (6) *Arsye zakonore*: Shumë gra muslimane mbajnë *hixhabin* si një mënyrë për të nderuar familjen, shoqërinë dhe zakonet e tyre. Një mësuese 35-vjeçare nga Arabia Saudite, e arsimuar në Shtetet e Bashkuara, tha: "Po, unë e mbaj mbulesën jashtë bindjes". -"Në çfarë e bazoni bindjen tuaj?" - pyeti [AlMunajjed]. - "Jam e lidhur me traditat e mia. Veshja e mbulesës është pjesë e identitetit të gruas saudite. Është provë e përcaktuar e identifikimit të dikujt me normat dhe vlerat e kulturës saudite ... dhe unë do ta mësoj edhe vajzën time që ta veshë këtë."²⁶
- (7) *Kërkesë e ligjit shtetëror*: Mbulimi kërkohet nga ligji i shtetit, si, p.sh., në Iran, pas Revolucionit të 1979-ës dhe në Afganistan, pas ardhjes së talebanëve në pushtet, në vitin 1998.

KUPTIMI I HIXHABIT: PIKËPAMJA E MEDIAVE PERËNDIMORE

Është shumë e lehtë të tregosh dallimet ndërmjet kompleksitetit sociologjik të motiveve dhe të kuptimeve që mbart mbulimi dhe imazhit standard që përcjell media perëndimore për motivet dhe kuptimet e mbulimit. Për median perëndimore, *hixha-*

25 Helen Watson, "Women and the Veil: Personal Responses to Global Process," në *Islam, Globalization and Postmodernity*, eds. Akbar S. Ahmed and Hastings Donnan (London: Routledge, 1994), f. 148. Nadia është gruaja e parë në familje që ka arsim universitar. Ajo tani po studion për mjekësi në universitet.

26 M. Al Munajjed, *Women in Saudi Arabia Today* (New York: St. Martin's Press, 1997), f. 47.

bi në përgjithësi, qëndron për shtypjen dhe si stenografi për të gjitha tmerret e Islamit (tani quhet fundamentalizëm islamik): terrorizmi, dhuna, barbarizmi dhe prapambetja. Kjo është një skemë e paracaktuar, në të cilën detajet empirike janë bërë për t'u përshtatur.

Ashtu si në kohën koloniale, kur mbulesa ishte metaforë e të gjithë Orientit, në vitet 1990 fjala “mbulesë” është shkurtim për të gjitha këto tmerre të fundamentalizmit islamik. Titujt shpallin: “Kërcënimi i mbuluar nga Islami”,²⁷ “Gratë e mbulesës: militantët islamikë që i shtyjnë gratë në një kohë të robërisë zyrtare”²⁸ “Foulard. Le Complot: Comment les Islamistes Nous Infiltrèrent [Mbulesa. Komploti: Si na infiltrojnë islamistët]”,²⁹ “Kërcënimi i mbuluar i Islamit”,³⁰ “Një akt besimi ose një kërcënim i mbuluar nga shoqëria?”,³¹ “Mbulesa muslimane kërcënon harmoninë në shkollat franceze, thotë Ministri”,³² “Ligji i Ri: Mbaj mbulesë dhe qëndro i gjallë”,³³ “Gratë e zëna prapa mbulesave”.³⁴

Kështu, *hixhabi* është i lidhur me pohimet rreth inferioritetit të grave brenda Islamit. “Mbulesa” supozohet të jetë një “shenjë e qartë e shtypjes së grave”,³⁵ e detyruar për gratë që nuk e dëshirojnë atë me metoda të ndryshme ryshfet,³⁶ ose kërcënime dhe dhunë aktuale.³⁷ Megjithatë, siç e pamë më lart, shumë gra në vendet muslimane veshin *hixhabin* me dëshirë dhe me bindje. Në duart e Scroggins, Goodwin dhe Brooks, këto gra shihen, në

27 *New Statesman*, 27 Mars 1992, faqja e kopertinës.

28 *The Atlanta Journal/The Atlanta Constitution*, qershor 28, 1992, Section F.

29 *L'Express*, (Quebec), nëntor 17, 1994, faqja e kopertinës.

30 *Le Nouvel Observateur*, shtator 28, 1994.

31 *Toronto Star*, maj 14, 1996, F5.

32 *Vancouver Sun*, shtator 15, 1994, A18.

33 *Montreal Gazette*, prill 11, 1994, B3.

34 *Toronto Star*, dhjetor 15, 1996, F4.

35 Deborah Scroggins, “Women of the Veil: Islamic Militants Pushing Women Back to an Age of Official Servitude,” *The Atlanta Journal/The Atlanta Constitution*, Sunday, qershor 28, 1992, f. P3.

36 Jan Goodwin, *Price of Honor: Muslim Women Lift the Veil of Silence on the Islamic World*, (New York: Plume, 1994), f. 262.

37 *Ibid.*, fq. 55, 789, 81, 98, 101, 1079, 293, 300; Scroggins, “Women of the Veil,” f. P3

rastin më të mirë, si të meta, të mashtruara ose të çuditshme. Dhe, në rastin më të keq, shihen si ideologe islamike, të përgjegjshme dhe fajtoresh si burrat për mbështetjen e një ideologjie kundërgruas.³⁸

Të rinjtë që u shfaqën dukshëm në studimet akademike rreth mbulimit të diskutuara më lart, janë paraqitur në studimin e Goodwin sikur tërhiqen lehtë nga “ekstremizmi”, për shkak të moshës së re dhe të kushteve të tyre socio-ekonomike. “Shumica dërrmuese” e tyre iu shmangën intervistës nga studiuesit e cituar më sipër.³⁹ Në duart e Brooks ata janë paraqitur si lajmëtarë të një të ardhmeje të zymtë, që e çonte vendin e tyre prapa në kohë. Në këto studime akademike nuk ekziston asnjë përjashtim a nuancë, siç janë, p.sh., vëzhgimi i Macleodit se mbulesa e re e shtresës së ulët në Kajro nuk lidhet drejtpërdrejt me lëvizjen islamike në Egjipt, ose theksi që Zuhur-i dhe Rugh-u i kanë vënë devotshmërisë⁴⁰; as kushtet social-ekonomike, ose perceptimi i Brennerit për gratë e gadishullit të Javës (në Indonezi) si gra që shohin para, gra racionale dhe moderne që kërkojnë të ridisiplinojnë veten dhe të përmirësojnë shoqërinë e tyre.⁴¹

38 Goodwin, *Price of Honor*, f. 112, 161, 1867, 217, 247, 342. Goodwin paraqet disa gra që nuk mbulohen si fundamentalistët dhe nuk kanë frikë nga fundamentalizmi, f. 85; Scroggins, “Women of the Veil,” f. P2. Geraldine Brooks, *Nine Parts of Desire: The Hidden World of Islamic Women*, (N.Y.: Doubleday, 1995), f. 8.

39 Goodwin, *Price of Honor*, f. 137, 175.

40 Andrea B. Rugh, *Reveal and Conceal: Dress in Contemporary Egypt* (Syracuse, New York: Syracuse University Press, 1986).

41 S. Brenner, “Reconstructing Self and Society: Javanese Muslim Women and the Veil,” *American Ethnologist*, 23, 4, (1996).



KAPITULLI I KATËRT

MERNISSI DHE DISKURSI MBI MBULESËN

Dy librat e feministes marokene Fatima Mernissi, “Përtej mbulesës” dhe “Mbulesa dhe elita mashkullore” janë konsultuar gjerësisht në Perëndim për “kuptimin” e mbulesës.⁴² Në të dy librat, Mernissi argumenton se mbulesa është një simbol i autoritetit të padrejtë mashkullor mbi gratë. Meqenëse libri im synon të zhvlerësojë stereotipin e mbulesës si shtypëse, atëherë është thelbësor një përgënjeshttrim kritik i argumenteve kryesore të Mernissit që gjenden në këto dy libra.

MERNISSI DHE METODOLOGJIA

Trauma personale, që Fatima Mernissi duket se ka përjetuar duke u rritur në Marok, nuk është kurrë larg sipërfaqes së shumicës

42 Fatima Mernissi, *Beyond the Veil: Male-Female Dynamics in Modern Muslim Society* (Revised ed, Indiana: Indiana University Press, 1987), dhe *The Veil and the Male Elite: A Feminist Interpretation of Women's Rights in Islam*, Trans. Mary Jo Lakeland (Reading, Massachusetts: AddisonWesley Publishing Co., 1991).

së shkrimeve të saj. Një anekdotë nga autobiografia e Mernissit ndriçon shumë mirë marrëdhënien e saj me mbulimin. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ajo nuk ishte ende nëntë vjeçe, ajo dhe kushërinjtë e saj përfunduan se ata duhej të ndryshonin ngjyrën e flokëve të tyre ose të mbuloheshin për të mbrojtur veten nga Hitleri i cili “urrente flokët e errët dhe sytë flokët dhe sytë e errët dhe hidhte bomba nga avionët kudo që e shihte një popullatë me flokë të errët.”⁴³ Mernissi filloi të veshë një prej shamive të nënës së saj, e cila më pas ia tërhoqi atë me zemërim. “Mos e mbuloni kurrë kokën!”- bërtiti nëna. “A më kuptove? Kurrë! Unë po luftoj kundër mbulesës, ndërsa ti po e vesh një të tillë?! Çfarë është kjo marrëzi? ... Edhe nëse HiHitleri, Mbreti i Plotfuqishëm i Allemanjës është pas jush,” – tha ajo, – “ju duhet ta përballonit atë me flokët tuaj të zbuluar. Mbulesa e kokës sate dhe fshehja nuk do të të ndihmojnë. Fshehja nuk zgjidh problemet e një gruaje. Ajo thjesht e identifikon atë si një viktimë e lehtë. Gjyshja dhe unë kemi vuajtur mjaft nga ky biznes i mbulimit të kokës. Ne e dimë që kjo nuk funksionon. Dua që vajzat e mia të çohen me kokat e tyre të ngritura dhe të ecin në planetin e Allahut me sytë e tyre në yje.”⁴⁴ Përballë kësaj, a mundet një fëmijë i vogël të zhvillojë diçka, përveç një qëndrimi të paqartë (ose negativ) për mbulimin? A mund të vendoste një grua e re që donte të mbulohej, pa u shikuar si e prapambetur apo antinacionaliste? Duket qartë se Mernissi është ende e traumatizuar nga këto kujtime dhe se tërë korpusi i saj është një kërkim për shkakun e dhimbjes së saj, si një mënyrë për ta ndryshuar dhe për ta shëruar atë. Kush nuk do ta dënonte një sistem të tillë?! Fakti që gratë e klasës së saj u mbajtën analfabete dhe u duhej të mbulonin fytyrën (*me nikab*), kur i lejonin të dilnin jashtë, e bën të vetëkuptueshëm qëndrimin e saj, që e barazon mbulesën me shtypjen e grave.

43 Fatima Mernissi, *Dreams of Trespass: Tales of a Harem Girlhood* (Reading, Massachusetts: AddisonWesley Publishing Co., 1994), f. 100.

44 Ibid.

Problemi është se Mernissi e njëson përvojën e saj të mbulesës në sistemin maroken me ‘përvojën e mbulesës’, me ‘kuptimin e brendshëm ose të vërtetë të mbulesës’. Siç do të shpjegoj më hollësisht më pas, Mernissi nuk arriti të njohë shumëllojshmërinë e praktikave islame të mbulimit (e, për rrjedhojë as kuptimet e tyre, siç përshkruhen në kapitullin e tretë) dhe shumëllojshmërinë e diskurseve islame rreth mbulesës. Ajo ndjek një qasje ahistorike që barazon sistemin social /politik /ekonomik maroken të shekullit të njëzetë me sistemin arab të shekullit të shtatë, me idenë se ajo që rezultoi në Marok në shekullin e njëzetë, është ajo që profeti Muhamed (a.s.) e përfytyroi si një ideal pozitiv të Islamit. Ajo, gjithashtu, e njëson gjendjen në Marok me gjendjen në të gjithë botën islame, në atë masë sa që diskuton për kuptimin e mbulesës në “rendin shoqëror musliman”, sikur Indonezia, Bangladeshi, Maroku, Arabia Saudite etj. të jenë sisteme identike me atë të komunitetit të parë musliman në Arabinë e shekullit të shtatë.⁴⁵

Pra, mosmarrëveshjet e mia kryesore me Mernissin janë dy: (1) qasja e saj ahistorike ndaj kuptimeve të simboleve fetare që nuk arrijnë të kontekstualizojnë mënyrën se si njerëzit e zbatojnë Islamin ndryshe në kohë dhe vende të ndryshme, dhe (2) qasja e saj reduktuese që nuk pranon shumëllojshmërinë e diskursit rreth mbulesës. Për të kundërshtuar stereotipin negativ se *hixhabi* është simbol i shtypjes islame ndaj grave, është me vend të pyetet nëse Islami kërkon llojin e shoqërisë që Mernissi e dënon si armiqësore ndaj grave apo ka vizione alternative që janë më të favorshme për gratë. Në këtë kapitull do të provoj se argumentet e Mernissit rreth pikëpamjes së Islamit për gratë kundërshtohen nga burimet e Islamit, Kurani dhe Hadithi (thëniet e profetit Muhamed a.s.). Debatimi im me Mernissin nuk është të mohoj se shoqëritë muslimane përfshijnë praktika represive ose diskurse për gratë. Mosmarrëveshja ime me të ka të

45 Mernissi, *Beyond the Veil*, f. 8z.

bëjë me Islamin normativ (a është vizioni kuranor antigrua apo jo?). Një interpretim i një vizioni kuranor që është i favorshëm për gratë, kundërvepron pikëpamjen e Mernissit dhe çdo interpretim tjetër kuranor që është shtypës i grave.

GRATË DHE SEKSUALITETI NË KURAN DHE SUNET

Rasti i Mernissit kundër mbulesës bazohet në përfundimin e saj se Islami e sheh seksualitetin e gruas si të rrezikshëm, prandaj duhet të kontrollohet. Ajo më tej argumenton se Islami e sheh 'femëroren' si antihyjnore apo të njollosur dhe se ai është kundër dashurisë heteroseksuale midis burrit dhe gruas. Sipas saj, gratë kërcënojnë marrëdhënien e burrave me Zotin, kështu që duhet të mbulohen, të izoloohen dhe të përjashtohen nga komuniteti musliman.⁴⁶

Asnjë nga këto argumente nuk mund të mbështetet nga leximi i kujdesshëm i Kuranit dhe i Sunetit. Siç vë në dukje Winter, Islami ka një "qëndrim seksual pozitiv", të ilustruar me thënien e Imam Neveviut: "Të gjitha orekset ngurtësojnë zemrën, me përjashtim të dëshirës seksuale, e cila e zbut atë."⁴⁷ Nuk ka asgjë në Kuran për gratë si qenie të rrezikshme seksuale. Përkundrazi, ekziston nocioni se burrat dhe gratë janë krejtësisht të njëjtë, duke u krijuar nga një shpirt i vetëm dhe duke qenë *të dy* përfutues të frymës hyjnore. (Pra, si mund ta shohë Islami femëroren si antihyjnore?) Kurani është i mbushur me vargje që theksojnë dashurinë dhe harmoninë reciproke martesore.

Është çudi që ajo i ka anashkaluar ato (p.sh. Kuran, 30:21). Piktura kuranore e dashurisë reciproke, konsideratës, dhemb-

46 Ibid.

47 T.J. Winter, "Desire and Decency in the Islamic Tradition," *Islamica* (United King dom), i, 4, (Janar 1994), f. 1112.

shurisë dhe harmonisë mes burrit dhe gruas është shumë larg nga pikëpamja e Mernissit: “Urdhri musliman dënon si një armik vdekjeprurës të qytetërimit: dashurinë midis burrave dhe grave në përgjithësi dhe midis bashkëshortit dhe bashkëshortes në veçanti.”⁴⁸

Për të theksuar, në Islam nuk ka asgjë të keqe ose të padëshirueshme për trupin dhe dëshirat e tij. Gruaja, ndonëse merr pjesë në Rënie, nuk mban përgjegjësi për dëbimin nga Parajsa (Adami po). Nuk ka mëkat origjinal (Zoti i fali ata menjëherë), dhe asnjë papastërti nuk i është bashkëngjitur asaj për shkak të këtij akti, si në traditat e tjera fetare. Dëshira në vetvete nuk është as nga djalli, as nga tensioni ndaj virtytit. Është konteksti që e përcakton virtytin. Domethënë, përmbushja e dëshirës seksuale në martesë inkurajohet dhe shpërblehet; përmbushja e dëshirës seksuale jashtë martesës dekurajohet dhe dënohet. Çdo veprim në jetën e një besimtari mund të jetë një akt adhurimi, nëse bëhet me qëllimin e duhur. Pra, marrëdhëniet seksuale, në vend që të shprehin antagonizëm midis Allahut dhe grave, janë një akt që u sjell shpërblime nga Zoti burrave dhe grave, kur kryhet në mënyrë të ligjshme. Kështu, *hixhabi* nuk është simbol i një besimi antifemëror në rregulla e që dëshiron të fshijë feminitetin, a të përjashtojë gratë nga bashkësia e besimtarëve.

PËRFUNDIM

Argumenti i Mernissit, që mbulesa përjashton gratë nga besimi, nga hapësira publike dhe kështu me radhë mohohet nga mendimet dhe veprimet e grave të shqyrtuara në Kapitullin e tretë dhe nga të intervistuarat e mia në Kapitullin e dytë. Duke shpërfi-

48 Mernissi, *Beyond the Veil*, f. 107.

llur zërat e grave të mbuluara dhe duke i zvogëluar ato në viktimasive, Mernissi vetëm po rimerr pikëpamjen koloniale dhe orientaliste të 'gruas së mbuluar'. Vizioni i saj është reduktiv, duke injoruar kompleksitetin sociologjik të mbulimit.

Nëse supozimi i saj, "se në Islam ka një kontradiktë me feminitetin dhe se hyjnorja kërkon që gratë të jenë të mbuluara dhe të përjashtuara (në këtë mënyrë të degraduara) në *hixhab* është i gabuar, ashtu siç argumentoj, *hixhabi* mund të ketë kuptim tjetër.



KAPITULLI I PESTË

NJË TEORI ALTERNATIVE E MBULESËS

Një nga qëllimet e këtij libri është të tregojë se konteksti social ndikon në kuptimet që i përshkruhen *hixhabit*. Në këtë kapitull, synoj të zhvilloj një teori pozitive të kuptimit të *hixhabit* për kulturën kapitaliste të konsumit të shekullit XXI. Unë argumentoj se, për shkak të theksit që kapitalizmi vë mbi trupin dhe mbi materialen, veshja me *hixhab* mund të jetë një përvojë fuqizuese dhe çliruese për gratë. I analizoj argumentet feministe për shikimin e meshkujve dhe për trajtimin e trupit femëror nga kapitalizmi si produkt, që të argumentoj se *hixhabi* është një mënyrë e fuqishme për t'u rezistuar aspekteve të dëmshme të të dyve. Në seksionet C, D dhe E, unë përgënjeshtroj disa kritika të përbashkëta të *hixhabit* si një fustan që thyen feminitetin, i bën gratë objekte seksi dhe iu mohon atyre zgjedhjet. Kapitulli mbyllet me seksionin F, i cili e paraqet *hixhabin* si portë hyrëse në një traditë besimi që i ndihmon pasuesit e tij për të përballuar efektet gërryese të materializmit modern.

A. HIXHABI DHE ÇLIRIMI

B. HIXHABI DHE SHIKIMI MASHKULLOR

Duke shkruar për shtypin kryesor, Naheed Mustapha dhe Sultana Yusufali paraqesin *hixhabin* si çlirim nga aspekte shtypëse të kulturës popullore të konsumit në Perëndim. Duke vepruar kështu, ata përdorin dy lloje analizash feministe.⁴⁹ Së pari, trajtimi i trupit femëror si objekt dhe produkt në kulturën kapitaliste. Së dyti, teoria e dëmit që u është bërë grave, duke promovuar një ideal bukurie.

Orbach, Bordo, Wolf, Ussher, MacKinnon, Dworkin dhe shumë feministe të tjera kanë analizuar në detaje imazhet e kulturave perëndimore të grave.⁵⁰ Ato shqyrtojnë problemin e trajtimit të trupit femëror si objekt dhe përdorimin e tij në reklama, pornografi, art, film e kështu me radhë. Argumenti kryesor është se trupat e grave paraqiten në mënyrë të atillë, që të kënaqin shikimin mashkullor (heteroseksual) dhe dëshirën (heteroseksuale) mashkullore: gruaja është e bukur dhe trupi i saj ndjell seksualisht. Në art (sidomos zhanrin e nudos femërore) dhe në pornografi, gruaja është shpesh pasive dhe e mbështetur, e ofruar si pronë për ta marrë burri.⁵¹

49 Naheed Mustapha, "My Body is my Own Business," *Globe and Mail*, Facts and Arguments, e marte, qershor 29, 1993; Yusufali: "My Body is My Own Business," *The Toronto Star*, e martë, shkurt 17, 1998, C:1.

50 Susie Orbach, *Fat is a Feminist Issue: A Self-Help Guide for Compulsive Eaters* (New York: Berkeley Books, 1979); Susan Bordo, *Unbearable Weight: Feminism, Western Culture, and the Body* (Berkeley, Calif.: University of California Press, 1993); Naomi Wolf, *The Beauty Myth: How Images of Beauty are Used Against Women* (1991, 2nd Ed, New York: Anchor, 1992); Jane Ussher, *Fantasies of Femininity: Reframing the Boundaries of Sex* (London: Penguin, 1997); Catherine A. MacKinnon, "Sexuality, Pornography, and Method: Pleasure Under Patriarchy," in *Feminism and Philosophy: Essential Readings in Theory, Reinterpretation, and Application*, eds. Nancy Tuana and Rosemarie Tong (Boulder: Westview Press, 1995); Dworkin, "Pornography is a Civil Rights Issue," in *Debating Sexual Correctness: Pornography, Sexual Harassment, Date Rape, and the Politics of Sexual Equality*, ed. Adele M. Stan (New York: Delta, 1995).

51 John Berger, Sven Blomberg, Chris Fox, Michael Dibb and Richard Hollis, *Ways of Seeing* (London: BBC and Penguin, 1972).

Në rastin e një fotoje / filmi 'marrja' është vizuale, megjithëse disa feministë argumentojnë se ky *objektifikim* vizual (i femrës) ka efekte në botën reale, që "i ndërton gratë si sende për përdorim seksual (nga mashkulli)".⁵² Për më tepër, ky pozicionim i trupit femëror nuk është i kufizuar vetëm në art, është kudo në imazhet ku ekzistojnë fotografi, sidomos në reklama: trupi i një gruaje me bikini që godet një sistem shkarkimi të makinave; këmbët e një gruaje që dalin nga kutia e drithërave ("Merrni më shumë reklama nga Kixi").⁵³ Marrëdhënia midis produktit që shitet dhe trupit seksual të gruas është zero; trupi është aty për të tërhequr vëmendjen. Gjithashtu nxit burrin heteroseksual dhe përforcon mësimin se trupat e grave janë objekte. Është argumentuar se, ky lloj *objektifikimi*, i dehumanizon gratë, i kthen ato në objekte dhe mohon personalitetin e tyre.

Është pjesë e rëndësishme e projektit feminist për ta ndryshuar dhe për ta përmirësuar këtë gjendje.

Mustapha dhe Yusufali e shohin *hixhabin* si një mënyrë për të dalë nga kurthi i *objektifikimit*, si një mjet që ia kthen gruas personalitetin. Përveç besimit se *hixhabi* heq efektet dëmtuese të shikimit të mashkullit duke i *deobjektifikuar* gratë, Mustapha dhe Yusufali argumentojnë se *hixhabi* është çlirues, sepse i shpëton gratë nga shkatërrimet e lojës së bukurisë. Loja e bukurisë është përpjekja e grave për t'u bërë imazhet e grave të bukura që i shohin të gjithë rreth tyre. Duke veshur rroba të gjata, të lirshme dhe duke mbuluar flokët me një shami, ato ndjehen të çliuara nga "skllavëria e lavjerrësit lëkundës të industrisë së modës dhe të institucioneve të tjera që shfrytëzojnë femrat" (Yusufali). Në zgjedhjen jashtë lojës së bukurisë, ato po përqafojnë si çlirues një simbol nga trashëgimia e tyre Islame, që të tjerët, në kontekste të tjera, mund ta kenë konsideruar shtypës.

52 MacKinnon, "Sexuality, Pornography, and Method," f. 142.

53 Michael F. Jacobson and Laurie Ann Mazur, *Marketing Madness: A Survival Guide for a Consumer Society* (Boulder: Westview Press, 1995), f. 845.

Pra, në zgjedhjen e *hixhabit* ato po ndërtojnë një identitet musliman, një identitet pakicë, përballë mesazheve të kulturës mbizotëruese (perëndimore) rreth grave për nevojën për t'u veshur në hap me modernen dhe për të qenë e hollë dhe e bukur. Ato përdorin trashëgiminë e tyre Islame si një mënyrë për t'u rezistuar e për t'u ngritur kundër këtyre imazheve të fuqishme të bukurisë ideale. Për këto dhe muslimane të tjera me mendime të ngjashme, *hixhabi* është një kundërmasë në Perëndim. Ato, madje, kanë versionin e vet të vetëdijes së rreme: "Gratë nuk do ta arrijnë barazinë nëpërmjet së drejtës për të nxjerrë gjinj të tyre në publik, ashtu si disa njerëz do të donin që ju të besoni", (Mustapha). Me këtë ua kanë kthyer tavolinat atyre feministeve, që e shohin mbështetjen e grave të reja për *hixhabin* si ndër-gjegje të rreme.

C. HIXHABI DHE FEMINITETI

Në vështrimin e atyre që e quajnë shfaqjen e trupit femëror si të drejtë dhe të përshtatshme ("Nëse e keni, krekosuni me të" është mesazhi i zakonshëm për gratë në kulturën perëndimore), "mbulimi i tij" e shtyp feminitetin dhe bukurinë. Rrobat shpesh të zymta të grave muslimane të mbuluara japin pamjen se feminiteti dhe seksualiteti i tyre po mohohen. Në këtë seksion, unë ngre katër pika, në mënyrë që të refuzoj supozimin se *hixhabi* zbut feminitetin dhe seksualitetin e një gruaje. Në radhë të parë, gratë nuk mbajnë *hixhabin* gjatë gjithë kohës. Megjithëse shpesh ilustrohet në këtë mënyrë, *hixhabi* nuk është një veshje publike / private: ajo lidhet me praninë ose mungesën e burrave të afërm ose jo të afërm. Pra, kur një grua është me të gjitha gratë apo burrat nga familja e saj, ajo nuk mbulohet. Në mënyrë të ngjashme, jashtë, nëse ajo është e lirë nga shikimi i burrave jo të

afërm, ajo nuk ka nevojë të mbulohet. Së dyti, gratë inkurajohen të vishen dhe të zbukurojnë veten, të ngazëllesh në trupat e tyre, me dhe për burrat e tyre. Së treti, sepse shumica e socializimit bëhet në një mënyrë të ndarë, gratë shpesh mblidhen pa burra të pranishëm. Për këto raste shumë gra duan të vënë grim, dhe veshin rroba të bukura. Një nga ngjarjet më spektakolare është festa martesore për nusen, ku gratë vishen me petkat e tyre më të bukura. Në disa prej këtyre festave, gratë kalojnë kohë duke dekoruar duart e njëra-tjetrës me modele kënaqe. Këndimi dhe vallëzimi janë të zakonshëm. Unë kam parë gra të moshuara duke kërcyer, duke duartrokitur dhe duke tundur ijët e tyre, duke nxitur një nuse të turpshme, të shtrënguar për t'i tundur ijët dhe trupin me më shumë energji. Dhe së katërti, janë evidente ngjashmëritë midis *hixhabit* dhe strategjive të tjera të grave për t'u përballur me vështrimin e meshkujve në hapësirat publike, të tilla si rruajtja e flokëve, e cila është e zakonshme në mesin e disa feministëve.

Ç. HIXHABI, SEKSUALITETI DHE ESENCIALIZMI

Feministët liberalë dhe *poststrukturalistë* supozojnë se sjellja dhe dëshira njerëzore janë ndërtuar në mënyrë shoqërore. Çdo strategji, siç është *hixhabi*, që duket se forcon dallimet tradicionale mashkullore / femërore, është e dyshimtë.

Kurani në vetvete nuk ofron shpjegime të detajuara për urdhërimet e tij për t'u mbuluar, as për dallimet në veshjen mashkullore / femërore. Megjithatë, ai ofron dy shpjegime të shkurtra që mund të jenë të mjaftueshme. Kur shqyrtojmë ajete të tilla si surja 24: 31, në të cilën gratë kërkohen të “tërheqin *khumurihinna* e tyre [zakonisht lloj mbulesë] mbi kraharror” dhe [33: 59] “të hedhin mbulesën e tyre të jashtme mbi vete [kur

janë jashtë shtëpisë]. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët”. Besoj se Kurani po argumenton se në arenën publike ka diçka për marrëdhëniet mashkull / femër që mund të jetë e dëmshme për gratë, dhe veshja e një veshje të jashtme mund ta lehtësojë. Kurani lë pa përgjigje saktësisht se si dhe çfarë veshje mund të ndihmojë, por, kur lexohet një ajet në suren 24, që urdhëron burrat dhe gratë të “ulin shikimin dhe të ruajnë modestinë e tyre” (24: 3031), unë supozoj se Kurani po tregon fenomenin e shikimit të meshkujve tashmë të analizuar më lart, dhe duke vendosur parësinë e shikimit për seksualitetin mashkullor.

Esencializmi është i rrezikshëm kur mishëron ‘mashkull / femër, superior / inferior’ dhe mund të përdoret, ashtu siç është përdorur, gjatë shekujve për t’iu mohuar grave të drejtat themelore për jetën, arsimimin, votimin e kështu me radhë. Megjithatë, Kurani nuk i vë këto dallime midis meshkujve dhe femra ve. Në të vërtetë, unë sugjeroj që ai deklaroi një ngjashmëri thelbësore mes meshkujve / femrave, si në ajetin 4: 1: “O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, e nga ai krijoi bashkëshorten e tij!” Ajo që na ofron Kurani, është një përshtatje e rreziqeve të qëndrueshme që mund të gjenden për gratë në arenën publike. Mbulimi për gratë diskutohet më shumë si një strategji sesa si një deklaratë e identitetit femëror / mashkullor të esencës. Në fund të fundit, gratë e vjetra lejohen të zbulohen (24:60). Në dallim nga pozicioni liberal / postmodern që shprejon se socializimi do të eliminojë përfundimisht ngacmimet e burrave ndaj grave, Kurani sugjeron që ky është një tipar i qëndrueshëm i ekzistencës njerëzore. Kjo nuk duhet të nënkuptojë determinizëm biologjik, kromozomet XY do të thotë janë ngacmues të gruas: shumica e burrave i trajtojnë mirë gratë. Është socializimi më shumë ai që e bën këtë sjellje mashkullore vazhdimisht të përsëritur.

Pra, argumenti im është se *hixhabi* nuk e mohon seksualitetin e një gruaje. Por vetëm se shoqëria shërbehet më mirë duke

mbajtur nën kontroll seksualitetin mashkullor dhe femëror, brenda dhe jashtë shtëpisë, sidomos në sferën publike.

D. HIXHABI DHE ZGJIDHJA

Studiuesit e lëvizjes për rimbullim, si dhe perëndimorët në përgjithësi, janë dyshues për zgjedhjen e grave për t'u mbuluar. Mbetet një bindje e thellë se gratë janë të detyruara në 'zgjedhjen' për t'u mbuluar. Ideja është diçka si: 'Nëse keni zgjedhur të mbuloheni, mirë, ju jeni socializuar të besoni se mbulimi është një gjë e mirë. Sidoqoftë, nëse e njihni me të vërtetë interesin tuaj si një grua, do ta dini se nuk është mirë të mbuloheni, prandaj vendimi juaj për t'u mbuluar është një shenjë e trishtuar e të qenit tru shpëllarë. Sigurisht, kështu mendoja para se të bëhesha muslimane.

Marrëdhënia midis kulturës së një individi dhe aftësisë së tij për të zgjedhur është komplekse, zgjedhja gjithnjë kufizohet nga diapazoni midis asaj që një kulturë e konsideron të pranueshme dhe të papranueshme. Edhe në Perëndim, siç argumentova në kapitullin e tretë, ku ekziston një liri e madhe, ka parametra për zgjedhjet e njerëzve. Shumica e shoqërive perëndimore ende presin që gratë të mbulojnë gjoksin e tyre në publik (përveçse në vendet specifike të hapësirës si një plazh / kamp nudist). Askush nuk do të argumentonte me të vërtetë, se gratë po detyrohen nga kultura e tyre, që të mbulojnë gjoksin vetëm për shkak të këtij sanksioni kundër zhveshjes nga beli e lart. Shumica e grave pranojnë kufizimet dhe mendojnë se po 'zgjedhin' të mbulojnë gjoksin kur vishen.

I njëjtë është rasti i *hixhabit*: ai është një veshje e pranuar në kulturën e shumë shoqërive islame, të cilën gratë muslimane mund të zgjedhin ta mbajnë (megjithëse ka shoqëri të tjera që

e kanë harruar *hixhabin*, siç ishte Turqia, një shembull i njohur bashkëkohor). Natyrisht, ajo që unë po argumentoj, vlen vetëm për shoqëritë që lejojnë zgjedhjen e vërtetë të femrës, e jo vendet si Irani apo Afganistani i talebanëve, ku gratë pengohen nga ligji për t'u zbuluar, ose gjatë periudhave të trazirave sociale në botën muslimane, ku *hixhabi* shihet si shenjë besnikërie dhe dhuna përdoret kundër grave për t'i detyruar që të mbulohen. Ky lloj i dhunës ndaj grave është i papranueshëm. Dua të flas këtu vetëm për marrëdhënien e *hixhabit* me zgjedhjen, në shoqëritë ku ekziston liria e vërtetë për ta mbajtur ose jo *hixhabin*.

DH. HIXHABI DHE TË QENIT FETAR

Për shkak të sanksionimit të tij fetar dhe për shkak të devotshmërisë, kur vishet me vetëdije nga një grua muslimane, si shumë nga të intervistuarat e mia në kapitullin e dytë, *hixhabi* vepron si portal në besimin islam. Ashtu si edhe fetë e tjera të mëdha botërore, mësimet e Islamit vënë theksin në jetën e përtejme dhe paralajmërojnë besimtarët të mos mashtrohen nga joshja prej të mirave të kësaj bote. Kurani drejton mendjet e njerëzve në Ditën e Llogarisë, ku secili shpirt do të ketë veprat e tij të mira dhe të këqija të vëna në një peshore. Përkushtimi, ne jemi të përkujtuar vazhdimisht, është më i rëndësishëm sesa gjërat e kësaj bote, në të cilat përfshihet edhe veshja. Pra, edhe pse veshja e *hixhabit* si akt devotshmërie mund të jetë fuqizues, ai është, në të vërtetë, vetëm një nivel fillestar. Një hadith në *Sahih Muslim* thotë: "Allahu nuk sheh pamjen ose pasurinë tuaj, por sheh zemrat dhe veprat tuaja" (nr. 2564).

Një tjetër mënyrë se si *hixhabi*, kur vishet për të shfaqur fetarinë, mund të kundërshtojë kulturën materialiste të kapitalizmit është, mesazhi i Kuranit rreth përsosjes së trupit njerëzor.

Çrregullimet e të ngrënit dhe pakënaqësia e trupit po arrijnë përmasa epidemike në Perëndim, megjithatë kjo është e mundur vetëm në një kulturë që nuk beson më se Zoti i bën të gjitha gjërat, duke përfshirë edhe formën e trupit. Mund të jetë e vërtetë që trupi është një vend i praktikës dhe i formimit kulturor, kështu që nuk ekziston një “trup biologjik”.⁵⁴

Është gjithashtu e vërtetë, ndërkaq, se njeriu nuk mund të ndryshojë shumë strukturën e trupit, pa iu nënshtruar kirurgjisë. Megjithëse mund të mbahet dietë dhe të bëhen ushtrime, nëse dikush qëndron brenda kufijve të shëndetshëm (d.m.th. pa anoreksi / bulimi), ka caq shumë përpjekje për t’u bërë. Mesazhi i Kuranit është të jesh i lumtur dhe i kënaqur me trupin tënd, sepse Zoti krijoi formën tonë: “Është Ai që ju formon në mitra, sipas dëshirës së Tij” (3: 6). Dhe Ai na krijoi “në formën më të mirë” (95: 4). Profeti (a. s.) i këshillonte njerëzit të ishin të shëndetshëm dhe të konsumonin e të ushtroheshin me maturi.

Kështu, Islami vepron si i kundërt me materializmin e kapitalizmit. Me vënien e *hixhabit*, gratë muslimane hyjnë në një traditë të thellë fetare që siguron burime fizike pozitive, për të penguar efektet gërryese të materializmit.

E. PËRFUNDIM

Argumenti i paraqitur në këtë kapitull është se *hixhabi* vepron si mjet fuqizues i rezistencës ndaj lojës së bukurisë, që luan kultura kapitaliste e konsumit të shekullit XXI. Lojë kjo, e cila ka një ndikim kaq të dëmshëm në vetëvlerësimin dhe shëndetin fizik të grave.

Hixhabi është, gjithashtu, një veshje autentike fetare dhe lidhja e tij me fenë u jep atyre që e vënë, një portë në traditën e

54 Bordo, *Unbearable Weight*, f. 290. Also f. 2467, 275.

besimit që ngre vetëbesimin, duke u kujtuar njerëzve se vlera e tyre nuk bazohet në pamjen, por në veprat e tyre të devotshme. Nga ky prizëm, *hixhabi* është simbol i një feje që i trajton gratë si persona e jo si objekte seksuale. Ky është saktësisht konkluzioni i kundërt me mendësinë feministe se *hixhabi* është simbol që Islami i sheh gratë si objekt seksual; se ajo duhet të mbulohet ngaqë mendohet në mënyrë reduktive si ‘femër’, atributi i vetëm i së cilës është seksualiteti i saj që kërcënon rendin shoqëror.



PËRFUNDIM

Libri im filloi me përpjekjen për të kuptuar pse një shoqëri liberale laike, që supozohet të jetë neutrale, lidhur me mënyrën se si individët ndjekin të mirën, reagueshan keq për konvertimin tim në muslimane dhe për veshjen e *hixhabit*. Kërkimi im më ka çuar në një udhëtim nga kohët koloniale, kur evropianët u takuan për herë të parë me *hixhabit*. E vazhdon deri në kohën e sotme, kur, pas braktisjes së *hixhabit*, disa gra muslimane e kanë veshur atë përsëri. Kam paraqitur zërat e disa grave muslimane të mbulura që jetojnë në Toronto dhe kam analizuar zërin e theksuar të një gruaje në kundërshtim me *hixhabit*. Së fundi, jam përpjekur të artikuloj një teori pozitive të *hixhabit* për kulturat kapitaliste të shekullit XXI.

Hixhabi është një filozofi rreth veshjes mashkullore e femërore dhe një etiketë për marrëdhëniet mashkull / femër. Megjithatë, është pjesë e rrobave që mbulon trupin e një gruaje në shkallë të ndryshme, e njohur edhe si *hixhab*, që është fokusi i armiqësisë në Perëndim, si dhe një vend i një lufte të hidhur në botën muslimane. Në Turqi (dikur) dhe në Tunizi, ligjet që ndalojnë *hixhabit*, janë miratuar në emër të “modernizmit”, një modernizëm i mbështetur në pikëpamjen orientaliste që e sheh Islamin si të prapambetur, anticivilizues, barbar dhe shtypës të

grave. Në këtë pikë, këndvështrimi i përbashkët perëndimor për mbulesën si shtypëse dhe përpjekjet e botës muslimane për të shmangur *hixhabin* konvergojnë.

Deri më sot, paradigmat feministe nuk e kanë kapur përvojën pozitive të grave të mbuluara me *hixhab* dhe as kanë kapur diversitetin në lidhje me mbulimin që mbizotëron në të gjithë botën. Është diskutimi i ashpër orientalist / feminist e jo *hixhabi* ai që i bën të padukshme femrat muslimane, duke i konsideruar gratë e mbuluara kukulla të heshtura, të paafta për të folur për veten e tyre. Feministët perëndimorë, duke harruar shtypjet me të cilat gratë përballen në kulturën e tyre, i trajtojnë gratë muslimane si grupi i vetëm i mbetur në botë që vuan nga shtypja. Kështu, roli i politikës së pushtetit në vazhdimin e stereotipit shtypës të *hixhabit* nuk mund të neglizhohet. Në shumë mënyra, diskursi anti*hixhab* është i lidhur me projektin e hegjemonisë perëndimore, edhe nëse kjo hegjemoni shihet si e natyrshme dhe jo rezultat i kësaj apo i asaj politike të jashtme specifike.

Disa do të kundërshtojnë me të drejtë. Në shumë shoqëri muslimane, gratë kanë qenë dhe janë të izoluar; ato kanë qenë dhe janë të detyruara të mbulohen. *Hixhabi* ka qenë pjesë e një pakete që kufizon potencialin e grave, duke u mohuar atyre arsimimin, punësimin jashtë shtëpisë dhe votimin. Nuk është çudi që, ashtu si Mernissi, shumë gra muslimane bëjnë fushatë kundër *hixhabit* dhe festojnë zhdukjen e tij. Lëvizja e re e mbulesës është një sfidë radikale për stereotipin perëndimor të shtypjes dhe për disa praktika tradicionale muslimane. Kthimi në lëvizjet e Kuranit dhe Sunetit (nga të cilat ekzistojnë disa versione) përmban brenda tij shumë forca. Ka nga ata, duke përfshirë edhe veten time, të cilët e shohin Kuranin, Sunetin, Profetin dhe komunitetin e parë si personifikim të barazisë dhe të drejtësisë për gratë dhe burrat, por një mënyrë jetese të shtrembëruar nga shtesat kulturore gjatë 1400 viteve të fundit. Këta muslimanë, burra dhe gra, po pohojnë se *hixhabi* (duhet) të ndahet nga tradi-

tat shtypëse të së kaluarës, siç është izolimi, dhe se këto shtypje gabimisht i pengonin gratë nga pjesëmarrja e tyre e ligjshme në çështjet e komunitetit. Ato kërkojnë arsim, punë, kontribut politik dhe *hixhab*.

Këto ndryshime mendimi mbi *hixhabin* nuk duhet të lejojnë të kapërcejnë komunitetin musliman sot. Ndryshimi në mendime ishte tipar i dukshëm i ditëve të hershme të Islamit. *Hixhabi* shpesh shihet me obsesion, sikur të ishte gjëja që e bën një grua të jetë muslimane ose jo. Harrohet se është *shهادeti* (deklarimi dhe besimi se askush nuk është i denjë për adhurim përveç Zotit dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij) ai që e bën dikë musliman dhe më pas vepra më e rëndësishme është të falësh në kohë. Tradita profetike na kujton se, përndryshe, gratë muslimane praktikante mund të ndëshkohen në jetën e ardhshme, në qoftë se kanë bërë thashetheme në këtë jetë.

Shkalla e veprave të një personi nuk është detyra jonë për t'u shqetësuar. Çfarë duhet të na shqetësojë më shumë se si është mbuluar një grua, janë sjellja dhe veprimet tona. Pra, ana "konservatore" e jona duhet të jetë e kujdesshme ndaj arrogancës dhe denoncimit të atyre që nuk dëshirojnë të mbajnë *hixhabin*; ashtu siç duhet të jetë e tillë edhe ana "progresive" e jona në denoncimin e atyre që dëshirojnë të mbajnë *hixhabin* ose *nikabin*. Mbi të gjitha, duhet të mbështetet liria e ndërgjegjes, nga të dyja palët.

Që kur e bëra për herë të parë hulumtimin tim, midis muslimanëve është ngritur një diskutim, se *hixhabi* nuk është një veshje e sanksionuar fetare por kulturore. E hetova këtë ndërsa po merrja vendimin për t'u konvertuar dhe arrita në përfundimin se argumenti ishte bazuar në prova të dobëta dhe logjikë të paqëndrueshme. Shqetësohem që rritja e trendit se "*hixhabi* nuk është kërkesë fetare", përderisa mbështetet kaq shumë në Perëndim, shërben vetëm për të marginalizuar më shumë se kurrë gratë muslimane, që *duan* të mbulojnë kokën ose fytyrën.

Zërat e tyre tani janë shtyrë në margjinat e zakonshme të diskutimit kulturor perëndimor dhe të diskutimit progresiv musliman. Jo të gjitha gratë e intervistuarra për këtë libër kishin veshur apo dëshironin të vishnin mbulesën e kokës, por shumë prej tyre ishin të veshura. Dhe kuadri i përgjithshëm i librit mbështet pikëpamjen se *hixhabi* është një veshje e sanksionuar fetare që nuk tregon shtypje, por është pjesë e një feje që i jep gruas muslimane dinjitet e respekt.

Kështu, punimi "*Duke rimenduar gratë muslimane dhe mbulesën*" shpresojmë që të shërbejë si vështrim alternativ në këto debate. Libri im është një përpjekje për të paraqitur një tjetër histori të mbulesës: historinë e atyre si unë, të cilët gjejnë paqe e gëzim në Islam dhe nuk besojnë se Islami i ndrydh gratë, apo se *hixhabi* i shtyp ato. Libri im është një përpjekje për të hapur linjat e komunikimit me ata që janë të gatshëm të dëgjojnë. Është një kërkesë që gratë muslimane të cilave u pëlqen të mbajnë *hixhabin*, të trajtohen me respekt, të dëgjoen me mirësjellje dhe të diskutohet me to me frymën e vullnetit të mirë. Le të pajtohemi që të mos biem dakord rreth çështjeve të caktuara, por, së paku, të mbetemi partnerë në fshatin global.



AUTORJA

KATHERINE BULLOCK përfundoi studimet Ph.D. në Shkencat Politike në Universitetin e Torontos, në vitin 1999. Ajo ka dhënë mësim dhe ka ligjëruar në Kaliforni dhe Toronto për Civilizimin dhe Politikën Islame. Emërimi i saj më i fundit është në Universitetin e Torontos, ku është duke dhënë mësim që nga viti 2002, një kurs të titulluar “Politika e Islamit”.

Aktualisht është Presidente e Institutit Tessellate, një institut kërkimi jofitimprurës, si dhe presidente e Compass Books, një kompani botuese e sapo themeluar. Ka qenë redaktore e Revistës Amerikane të Shkencave Sociale Islame (AJISS) nga 2003-2008, si dhe Zv. Presidente e Shoqatës së Shkencave Sociale Muslimane (Amerika Veriore) nga 2006-2009.

Botimet e saj përfshijnë: *“Aktivistet e grave muslimane në Amerikën e Veriut: Duke folur për veten tonë”* dhe *“Duke rimenduar gratë muslimane dhe mbulesën: Sfida ndaj stereotipeve historike dhe moderne”*, i cili është përkthyer në frëngjisht dhe në turqisht.

Ajo është një aktiviste e komunitetit dhe ligjëron shpesh, si për grupet muslimane, ashtu edhe për ato jomuslimane. Me origjinë nga Australia, jeton në Kanada me bashkëshortin dhe fëmijët e saj. E përqafoi Islamin më 1994.

Seria e Librave të Shkurtër të INMI është një koleksion i vlefshëm i botimeve kryesore të Institutit i shkruar në formë të kondensuar për t'u dhënë lexuesve një kuptim thelbësor të përmbajtjes kryesore të origjinalit.

Nevoja për të sfiduar stereotipin negativ të mbulesës si shtypëse është urgjente. Ajo është në mendjet e shumë njerëzve dhe debati për ta veshur apo për mos ta veshur është duke u bërë gjithnjë e më i nxehtë, pasi mediat kryesore e barazojnë atë me prapambetjen muslimane dhe barbarizmin. Ky punim përqendrohet në pikëpamjen kulturore perëndimore që mbulesa është shtypëse për gratë muslimane dhe nxjerr në pah modelet e pushtetit që qëndrojnë pas këtij imazhi të ndërtuar të mbulesës. Ky punim gjithashtu shqyrton rrënjët koloniale të këtij stereotipi negativ dhe sfidon me sukses argumentet e feministëve liberalë, si Mernissi, për të pohuar se në një kulturë të konsumerizmit, mbulesa mund të përjetojë si një çlirim nga tirania e mitit të bukurisë dhe 'idealit' të gruas së hollë.

Shaykh Hamza Yusuf Hanson, Themelues dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve, Instituti Zaytuna

Mbulesa është një pikë e nxehtë në diskursin aktual islamik. Janë shkruar shumë pjesë interesante, por pak nga personat e brendshëm me kredenciale feministe. Ky libër duhet të lexohet nga ata që janë të përfshirë në skenën aktuale muslimane. Në Lindje apo në Perëndim. Libri i Dr. Bullock meriton vëmendje serioze pasi sfidon supozimet më të thella që ne në Perëndim kemi për mbulesën dhe kuptimin e saj.

Julian Bond, Drejtor, Forumi Musliman Kristian

Ky është një libër me kohën, më shumë se kur u botua fillimisht. Perspektiva e autorit është e një gruaje 'perëndimore' që kishte dyshime rreth 'mbulesës', e cila më pas filloi të veshë hixhabin kur ajo u bë muslimane. Është një lexim freskues, i shkruar mirë, i sinqertë dhe me të vërtetë interesante. Ndryshe nga vëmendja e madhe që zakonisht i jepet kësaj çështje autorja ka dëgjuar në të vërtetë përvojën e grave muslimane të veshjes së hixhabit dhe u lejon atyre të flasin me fjalët e tyre. Shpresoj që ky libër të informojë lexuesit e rinj në mënyrë që ata të mund të reflektojnë për veten e tyre në këtë çështje.



Seria e Librave
të Shkurtër INMI